

VENDIM
Nr.680, datë 11.10.2006

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, TË DISA MJEDISEVE SHOQATËS SË
INVALIDËVE TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, pa kundërshtëpërblim, shoqatës së invalidëve të punës të disa mjediseve, zyra me sipërfaqe 114 m², në ndërtesën e Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Mjediset, në përdorim të Shoqatës së Invalidëve të Punës, në katin nëntokë, të ndërtesës së ish-Komitetit Qendror, të kalojnë në dispozicion të Këshillit të Ministrave.


3. Ngarkohen Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojcë 1

Planimetri Sh 1:100
OBJEKTI; ISH-ZYRAT E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, TIRANË



Adresa: Rr. Elbasanit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
Kati Përdhe